

## **SPECIFIKIMET TEKNIKE**

Qeveria Shqiptare është duke zbatuar “Programin e Rindërtimit të Infrastrukturaes së dëmtuar nga pasojat e tërmetit të Nentorit 2019”, e cila do të vihet në shërbim të qytetareve të prekur nga fatkeqesia natyrore, bazuar në parimin "ndërto përseri më mirë".

Programi ka si synim :

- Rindërtimin e banesave individuale apo edhe atyre kolektive në funksion të strehimit në kushte optimale për banorët që rezultojnë të pastrehë si pasojë e tërmetit.
- Rindërtimin e objekteve të infrastrukturese sociale, si ato arsimore, shëndetësore apo të kujdesit social;
- Rindërtimin e Infrastrukturës së objekteve administrative të institucioneve shtetërore, vendore apo ato të sistemit gjyqësor,
- Rindërtimin e infrastrukturese publike dhe kritike shoqërore dhe në funksion të objekteve të siperpërmendura.

Fondi Shqiptar i Zhvillimit është caktuar si njësi zbatuese për “Programin e Rindërtimit në Zonat e Prekura nga Tërmeti” për rindërtimin e infrastrukturese banesave individuale dhe kolektive, objekteve arsimore dhe infrastrukture publike në zonat e prekura nga tërmeti dhe specifikisht për zonat e reja për zhvillim në Bashkitë Durrës, Kamëz, Kavajë, Rrogozhinë, Krujë, Kurbin, Lezhë, Mirditë, Shijak dhe Vorë.

Në funksion të këtij programi dhe në zbatim të detyrave të tij, FSHZH kërkon angazhimin e kompanive të kualifikuara dhe të afta për ndërtimin e infrastrukturese publike në zonën e prekur nga tërmeti dhe shpall këtë procedurë prokurimi për marrëveshje kuader në vijim të Kreut VI të Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 për përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrore.

Objekti i punës së kësaj Marrëveshje Kuader konsiston në:

Rindërtimin e njësive të banimit (pallat) në zonat e prekura nga tërmeti, për të cilat FSHZH është njësi zbatuese të cilat përkufizohen si struktura, që ndërtohen ose krijohen nga fillimi. Ato janë objekte, të shkatërruara që rindërtohen në truall ekzistues ose sipas përcaktimeve të planeve të detyruara vendore në zonat e shpallura për zhvillim.

**“Projektimin e Detajuar dhe Ndërtimin e Njësive të Banimit Pallat” që përfshin në vetvete 2 faza:**

- a) Përpunim dhe detajim i punës së bërë në fazat 3 dhe 4 (zhvillimi dhe paraqitja hap pas hapi e projektit të zgjidhur) duke marrë parasysh planin e qytetit/ PPV dhe PDYZH, funksionin e përdorimit, gjendjen teknike dhe fizike të ndërtimit, efikasitetin financiar dhe energjitike, plotësimin e gjithë dokumentacionit teknik, relacioneve dhe specifikimeve teknike, lidhjen me rrjetin e instalimeve të infrastrukturave (energji elektrike, furnizimi me ujë të pijshëm, shkarkimet e ujërave të përdorur dhe ujërave të shiut, telefonise dhe internetit/ TIK) si dhe

preventivi perfundimtar, dhe cdo dokumentacion Teknik tjetër në funksion të zbatimit të projektit, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

- b) Ndertimin e objekteve të banimit mbi parimin “nderto perseri me mire”. Rimëkëmbja nga gjendja e fatkeqësisë natyrore ka si qëllim, për aq sa është e mundur, garantimin e kthimit në kushte optimale jetese.

Ndertimi njesive të banimit (pallat) do të shtrihet në zonat e përqendruara për zhvillim të detyruar sipas tabelës me poshtë, në gjithë territorin e Bashkive të prekura nga tërmeti, duke përfshirë sipas rastit, ndertime pikësore (ndertimi në të njëjtin vend me objektin e mëparshëm) aty ku do jete e nevojshme.

Nr	VKM Nr	Date	Zona	Vendndodhja/Qellimi	Bashkia /Qyteti
1	44	22.01.2020	Zona 1	Zone e re për zhvillim Thumanë	Kruje
2	45	22.01.2020	Zona 1	Zone e re për zhvillim Shijak	Shijak
3	61	29.01.2020	Zona 1	Zone e re për zhvillim Bubq	Kruje
4	62	29.01.2020	Zona 1	Zone e re për zhvillim Ish-Uzina Mekanike Bujqsore	Durres 1
5	63	29.01.2020	Zona 1	Zone e re për zhvillim	Fushe-Kruje/Kruje
6	64	29.01.2020	Zona 1	Zone e re për zhvillim	Kavaje
7	65	29.01.2020	Zona 1/2	Zone e re për zhvillim	Lac/Kurbin
8	66	29.01.2020	Zona 1	Zone e re për zhvillim	Vore
9	129	13.02.2020	Zona 2	Zone e re për zhvillim	Durres
10	130	13.02.2020	Zona 3	Zone e re për zhvillim	Durres
11	131	13.02.2020	Zona 1	Zone e re për zhvillim	Golem
12	132	13.02.2020	Zona 1	Zone e re për zhvillim	Kruje
13	133	13.02.2020	Zona 1	Zone e re për zhvillim	Lezhe
14	134	13.02.2020	Zona 2	Zone e re për zhvillim	Lezhe
15	135	13.02.2020	Zona 1	Zone e re për zhvillim	Marikaj, Bashkia Vore
16	442	3.6.2020	Zona 5	Zone e re për zhvillim	Durres
17	468	10.6.2020	FSHATIN VALIAS	Zone e re për zhvillim	Kamez
18	469	10.6.2020	Rrëshen	Zone e re për zhvillim	Miredite

Rindertimi nënkupton të gjithë proceset e punës së nevojshme për të patur një ndertese (pallat) të perfunduar funksionale dhe të jetueshme sipas legjislacionit, duke filluar nga:

- Planifikimi, mobilizimi dhe ngritja e kantierit;

- Demolimi largimi i inerteve dhe mbetjeve te objekteve dhe infrastruktures ekzistuese ne sheshet e ndertimit;
- Pergatitja e sheshit dhe punimet e germimit/mbushjes (nese ka);
- Pergatitja dhe ndertimit i themeleve/bazamentit, strukturave nentokesore
- Pergatitja dhe ndertimi i struktures/karabinase dhe muratures;
- Rifinitura dhe punimet e fasadave;
- Te gjitha instalimet e nevojshme (furnizimi me energji elektrike, telefoni dhe internet, furnizimi me uje te pijshem, shkarkimet e ujrave te perdorura etj..)
- Testimi dhe venia ne funksionim;
- Pergatitja e dokumentacionit perkates dhe dorezimi i objektit dhe dokumentacionit shoqerues tek mbikqyresi dhe investitori.

Projekt ideja dhe specifikimet teknike do të jepen sipas percaktimeve të Fteses për Ofertë per Fazen e dyte të procedures.